



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërinë Sauber Holding AG nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.517 prot.i AK, datë 08.08.2022 “Njoftim Përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përfkrimin e kontrollit të shoqërisë Sauber Holding AG, nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve nga shoqëria AUDI Aktiengesellschaft.

Referuar “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve” dhe “Marrëveshjes së aksionarëve” palët janë:

Blerësi: AUDI Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e mjeteve motorike dhe automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre dhe të gjitha makinerive, veglave dhe artikujve të tjerë teknikë.

AUDI Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar plotësisht nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruara indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Shitësi: Islero Investments AG është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: blerja, mbajtja, administrimi dhe shitja direkte ose indirekte e pasurive të paluajtshme në shoqëri vendase dhe të huaja; kryen transaksionet tregtare dhe financiare që drejtpërdrejtë ose tërthorazi, plotësisht ose pjesërisht, lidhen me qëllimin e shoqërisë ose mund të lehtësojnë realizimin e saj etj.

Islero Investments AG zotërohet nga Ridgeback Establishment AG, shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, e cila kontrollohet nga Fondacioni Barchetta.

Islero Investments AG, Ridgeback Establishment AG dhe Fondacioni Barchetta nuk kanë filiale dhe nuk kanë gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2021.

Shoqëria Target: Sauber Holding AG është një shoqëri përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Zvicrës, me objekt aktiviteti: investimin në shoqëri të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit dhe t’i financojë ato.

Sauber Holding AG nuk është prezente dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.